

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

PRANUAR

07/07/2023

Nj. Org.

Numër

Shtojca

Vlera

13

111/1

32553



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA- DRENAS
DREJTORATI PËR SHËRBIME
PUBLIKE DHE EMERGJENCË
Dt.07/07/2023



Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-179, për Transportin Rrugor ,nenit 15,paragrafi 2, nenit 8,paragrafi 2 i Rregullores për Transportin Rrugor, në territorin e Komunës së Drenasit me nr.06-7086, dhe Vendimit të Kuvendit për miratimin e linjave urbane-periferike në komunën e Drenasit nr. 12-031-14044, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë shpallë këtë:

K O N K U R S

Për linjat Urbano-Periferike të transportit të rregullt të udhëtarve me autobus të mirtatuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, për të gjithë Operatore e licencuar nga Ministria e infrastrukturës, bazuar në ligjit për Transport Rrugor, Komuna fton të gjithë Operoret e transportit rrugorë të udhëtarve me autobus, të interesuar që të aplikojnë për linjat si në vijim:

LINJAT :

1. Drenas-Nekoc
2. Drenas-Kizharekë
3. Drenas-Gradicë
4. Drenas-Verboc
5. Drenas-Tërstenik (lagja e Francëve)
6. Drenas-Abri
7. Drenas-Tërdec
8. Drenas-Vuçak
9. Drenas-Domanek
10. Drenas-Sankoc-Fushticë e Epërme
11. Drenas-Poklek i Vjetër-Vasilevë
12. Drenas-Dobroshec
13. Drenas-Polluzhë (lagja Istogu)
14. Drenas-Godanc
15. Drenas-Shtuticë
16. Drenas-Fushticë e Ulët

Kushtet për aplikim:

1. Kërkesën për aplikim,
2. Licencë valide për transport të udhëtarve me autobus , të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës,
3. Rendin e udhëtimit ku përfshinë : Emrin e operatorit, relacionin, radhitjen e vend-ndaljeve dhe largësin e tyre nga pika fillestare në km , kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në qdo stacion dhe vend-ndalje, ditet e operimit (periudha kohore në të cilën mbahet linja),
4. Vërtetim më të cilin vërtetohet se nuk është iniciuar ndonjë procedurë e pezullimit apo revokimit, mirret nga inspektori komunal,
5. Vërtetimi i lëshuar që vërteton se Operatori Ekonomik nuk ka borxhe të pashlyera të taksës komunale deri në vitin 2023,
6. Vërtetim (jo më të vjetër se 30 ditë nga ATK-ja për kontributet e paguara dëshmi Lista e pagesave për kompanitë, të vulosur nga ATK-ja, së paku në 6 muajt e fundit), kopjet e kontratave të punës dhe patent shoferi sipas kategoris për autobus –kopje,
7. Dëshmi për kapacitetet përkatëse të autobusëve (kopjet e librezave të qarkullimit dhe certifikatave të autobusëve të noterizuar),

Mënyra e Aplikimit:

Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentacionin duhet të dorëzohet në zyrën pritëse-kati i parë , Dokumentacioni dorëzohet në dy kopje, në dy zarfa të mbyllura prej të cilave në njërin duhet të jetë Origjinali ndërsa tjetra kopje,të shënuara (të mos hapet).

Komisioni do të zgjedhë Operatorin i cili i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në shpallje publike.

Aplikacionet hapën në lokalet e Komunës.

Aplikacionet e pa nënshkruara dhe të pavulosura nga Menaxheri i Operatorit të Transportit nuk do të shqyrtohen dhe do të konsiderohen si të anuluar.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e shpalljes, nga dt:07.07.2023 deri me 27.07.2023,ora16:00 dhe aplikacionet që dorëzohen pas kësaj date nuk pranohen.

Aplikacionet mirren në sportelet e zyrës pritëse.

Nisja e fundit prej Drenasi duhet të jetë prej orës 18:45-19:15, vlenë për të gjitha linjat dhe duhet të jenë të shënuara në rendet e udhëtimit.

Shënim:Ndërsa linjat për Krojkovë, Arllat- Bytyq, Gjurgjicë, Sankoc, Fushticë e Eperme,dhe Likoshan ju skadon afati në vitin 2024, nuk kanë nevoj pwr aplikim.

